



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË



Viti: 2018 – Numri: 3

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Tiranë – E enjte, 18 janar 2018

PËRMBAJTJA

	Faqe
Dekret i Presidentit nr. 10707, datë 4.1.2018	Për dhënie të shtetësisë shqiptare..... 35
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 8, datë 12.1.2018	Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 426, datë 15.5.2013, të Këshillit të Ministrave, “Për ngritjen, funksionimin dhe detyrat e Komisionit Kombëtar për Nomenklaturën”..... 35
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 9, datë 12.1.2018	Për një ndryshim në vendimin nr. 501, datë 13.9.2017, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Mbrojtjes”..... 36
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 10, datë 12.1.2018	Për një ndryshim në vendimin nr. 502, datë 13.9.2017, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Brendshme”..... 36
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 11, datë 12.1.2018	Për disa ndryshime në vendimin nr. 83, datë 28.1.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për krijimin dhe funksionimin e Agjencisë për Zbatimin e Reformës Territoriale”..... 36
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 13, datë 12.1.2018	Për miratimin e kalendarit të menaxhimit të shpenzimeve publike për vitin 2018..... 37
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 14, datë 12.1.2018	Për disa ndryshime në vendimin nr. 198, datë 4.5.1993, të Këshillit të Ministrave, “Për krijimin e Entit Kombëtar të Banesave”, të ndryshuar..... 39
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 15, datë 12.1.2018	Për miratimin e tarifave për shërbimet elektronike të Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit..... 39
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 16, datë 12.1.2018	Për miratimin e listës së veprimtarive që ushtrojnë ndërmarrjet sociale.. 40

Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 17, datë 12.1.2018	Për financimin e shërbimeve shëndetësore spitalore nga skema e detyrueshme e sigurimeve të kujdesit shëndetësor për vitin 2018....	41
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 19, datë 12.1.2018	Për mbulimin e pjesshëm të shpenzimeve të mjekimit të z. Moikom Zeqo.....	46
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 20, datë 12.1.2018	Për mbulimin e pjesshëm të shpenzimeve të mjekimit të z. Leonardo Frrokaj.....	46
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 21, datë 12.1.2018	Për disa shtesa në vendimin nr. 709, datë 29.10.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e Strategjisë Ndërsektorale për Zhvillimin Rural dhe Bujqësor 2014–2020”	46
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 22, datë 12.1.2018	Për miratimin e kriterëve për certifikimin e veprimtarisë së agroturizmit.....	53
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 1, datë 5.1.2018	Për delegim kompetencash.....	54
Urdhër i ministrit të Drejtësisë nr. 128, datë 5.1.2018	Për delegimin dhe disa rregulla të përfaqësimit ligjor të Ministrisë së Drejtësisë.....	55
Njoftim i Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme nr. 275, datë 9.1.2018	Mbi hyrjen në fuqi të një marrëveshjeje ndërkombëtare.....	56
Njoftim i Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme nr. 418, datë 11.1.2018	Mbi hyrjen në fuqi të disa marrëveshjeve ndërkombëtare.....	56

**DEKRET**

Nr. 10707, datë 4.1.2018

**PËR DHËNIE TË SHTETËSISË
SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, pika “c”, dhe nenit 93 të Kushtetutës, si dhe nenit 9 e nenit 20, të ligjit nr. 8389, datë 5.8.1998, “Për shtetësinë shqiptare”, të ndryshuar, bazuar edhe në propozimet e Ministrisë së Brendshme,

DEKRETOJ:**Neni 1**

U jepet shtetësia shqiptare, me kërkesë të tyre, personave të mëposhtëm:

1. Ardian Xhelal Hackaj (Haçkaj)
2. Hana Prenk Prenka
3. Ali Uğur Yaşar Bora
4. Vasil Harallamb Lefteri
5. Ilir Ramadan Brestovci
6. Meliha Ismail Brestovci (Abdullahu)
7. Miranda Elmaz Isa (Veis)
8. Xhevrije Fikri Mati (Demiri)
9. Frano Ambroz Čivljak
10. Semih Şahin Kurt
11. Veton Rufki Kiki
12. Cihan Muzaffer Saymali
13. Sabahat (Sebahat) Ethem Bilaç (Gülaçar)

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

**PRESIDENTI I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË**

Ilir Meta

VENDIM

Nr. 8, datë 12.1.2018

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA
NË VENDIMIN NR. 426, DATË 15.5.2013,
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR
NGRITJEN, FUNKSIONIMIN DHE
DETYRAT E KOMISIONIT KOMBËTAR
PËR NOMENKLATURËN”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 12/2, të ligjit nr. 9180, datë 5.2.2004, “Për statistikën zyrtare”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 426, datë 15.5.2013, të Këshillit të Ministrave, bëhen ndryshimet dhe shtesat, e mëposhtme:

a) Pika 2 ndryshohet si më poshtë vijon:

“2. Komisioni Kombëtar për Nomenklaturën kryesohet nga drejtori i Përgjithshëm i INSTAT-it dhe në përbërje ka përfaqësues nga:

- | | |
|--|------|
| a) Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme | 1; |
| b) Ministria e Brendshme | 1; |
| c) Ministria e Financave dhe Ekonomisë | 1; |
| d) Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë | 1; |
| e) Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë | 1; |
| dh) Ministria e Drejtësisë | 1; |
| e) Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural | 1; |
| ë) Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale | 1; |
| f) Ministria e Turizmit dhe Mjedisit | 1; |
| g) Ministri i Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes | 1; |
| gj) Banka e Shqipërisë | 1; |
| h) Shërbimi Kombëtar i Punësimit | 1; |
| i) Drejtorja e Përgjithshme e Doganave | 1; |
| j) Drejtorja e Përgjithshme e Tatimeve | 1; |
| k) Instituti i Sigurimeve Shoqërore | 1; |
| l) Qendra Kombëtare e Biznesit | 1; |
| ll) INSTAT-i | 2.”. |

b) Në fund të pikës 3 shtohen fjalët “... dhe brenda 10 (dhjetë) ditëve njoftojnë INSTAT-in ...”.

2. Ngarkohen Instituti i Statistikave dhe institucionet e përmendura në pikën 2 për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI
Edi Rama**

**VENDIM****Nr. 9, datë 12.1.2018**

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN
NR. 501, DATË 13.9.2017, TË KËSHILLIT
TË MINISTRAVE, “PËR PËRCAKTIMIN
E FUSHËS SË PËRGJEGJËSISË
SHTETËRORE TË MINISTRISË
SË MBROJTJES”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 5, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Pika 3, e vendimit nr. 501, datë 13.9.2017, të Këshillit të Ministrave, ndryshohet si më poshtë vijon:

“3. Ministria e Mbrojtjes planifikon e përballon emergjencat civile dhe vendos bazën juridike e administrative për rregullimin e marrëdhënieve që lindin, ekzistojnë dhe shuhen gjatë administrimit, mirëmbajtjes e kontrollit të pronësisë në rezervat materiale të shtetit.”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI**Edi Rama****VENDIM****Nr. 10, datë 12.1.2018**

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN
NR. 502, DATË 13.9.2017, TË KËSHILLIT
TË MINISTRAVE, “PËR PËRCAKTIMIN
E FUSHËS SË PËRGJEGJËSISË
SHTETËRORE TË MINISTRISË
SË BRENDSSHME”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 5, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Shkronja “e”, e pikës 3, e vendimit nr. 502, datë 13.9.2017, të Këshillit të Ministrave, shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI**Edi Rama****VENDIM****Nr. 11, datë 12.1.2018**

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN
NR. 83, DATË 28.1.2015, TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE, “PËR KRIJIMIN DHE
FUNKSIONIMIN E AGJENCISË
PËR ZBATIMIN E REFORMËS
TERRITORIALE”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 10, të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, të nenit 6, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, dhe të ligjit nr. 130/2016, “Për buxhetin e vitit 2017”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Në vendimin nr. 83, datë 28.1.2015, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime:

1. Në titull dhe kudo në vendim, emërtimi “Agjencia për Zbatimin e Reformës Territoriale” zëvendësohet me “Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore” dhe shkurtimi “AZRT” zëvendësohet me fjalën “... agjencia ...”.

2. Në pikën 1, fjalët “... në varësi të ministrit të Shtetit për Çështjet Vendore ...” zëvendësohen me “... në varësi të ministrit përgjegjës për çështjet vendore ...” dhe kudo në vendim, emërtimi “Ministri i Shtetit për Çështjet Vendore” zëvendësohet me fjalët “... ministri përgjegjës për çështjet vendore ...”.

3. Pika 4 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“4. Agjencia ka këto detyra dhe përgjegjësi:

a) Mbështet ministrin përgjegjës për çështjet vendore në koordinimin e punës për zbatimin e politikës së përgjithshme shtetërore në fushën e decentralizimit dhe qeverisjes vendore;



b) Monitoron zbatimin e Strategjisë Ndërsektoriale për Decentralizimin dhe Qeverisjen Vendore, 2015–2020, si dhe planit të veprimit përkatës;

c) Informon periodikisht institucionet publike, grupet e interesit dhe qytetarët mbi çështjet që lidhen me qeverisjen vendore;

ç) Bashkëpunon me strukturën përkatëse të ministrisë përgjegjëse për çështjet vendore për propozimin dhe përmirësimin e akteve ligjore e nënligjore në zbatim të Strategjisë Ndërsektoriale për Decentralizimin dhe Qeverisjen Vendore, 2015–2020;

d) Mbështet ministrin përgjegjës për çështjet vendore për krijimin dhe administrimin e një sistemi kombëtar unik, me synim zbatimin e funksioneve të deleguara të vetëqeverisjes vendore;

dh) Siguron informacione lidhur me çështjet e vetëqeverisjes vendore, me qëllim koordinimin e institucioneve publike qendrore e vendore dhe harton raporte, analiza periodike mbi këto çështje;

e) Ofron këshillim ligjor dhe teknik për njësitë e vetëqeverisjes vendore në procesin e ushtrimit të funksioneve të tyre;

ë) Shërben si qendër e evidentimit dhe e promovimit të praktikave më të mira dhe/ose modeleve rekomanduese për çështjet e vetëqeverisjes vendore;

f) Bashkërendon me strukturën përkatëse të ministrisë përgjegjëse për çështjet vendore për përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin në kuadër të procesit të integritetit në Bashkimin Evropian dhe të marrëveshjeve ndërkombëtare;

g) Mbështet ministrinë përgjegjëse për çështjet vendore (në rolin e një sekretariati teknik) në koordinimin e punës me organizmat dhe partnerët ndërkombëtarë që mbështesin zhvillimin e njërive të vetëqeverisjes vendore;

gj) Raporton periodikisht pranë ministrit përgjegjës për çështjet vendore mbi veprimtarinë e saj dhe për realizimin e detyrave të përgjegjësisë të përcaktuara në këtë vendim.”.

4. Pika 5 ndryshohet si më poshtë vijon:

“5. Organika dhe struktura e Agjencisë miratohen me urdhër të Kryeministrit, sipas legjislacionit në fuqi për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore.”.

5. Pika 7 ndryshohet si më poshtë vijon:

“7. Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë emërohet, lirohet ose shkarkohet me urdhër të ministrit përgjegjës për çështjet vendore.”.

II. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM

Nr. 13, datë 12.1.2018

PËR MIRATIMIN E KALENDARIT TË MENAXHIMIT TË SHPENZIMEVE PUBLIKE PËR VITIN 2018

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 22, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e kalendarit të menaxhimit të shpenzimeve publike për vitin 2018, sipas lidhjes nr. 1 që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë, njësia përgjegjëse për planifikimin strategjik dhe zhvillimin në Kryeministri, si dhe të gjitha njësitë e qeverisjes së përgjithshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe i shtrinë efektet nga data 1 janar 2018.

KRYEMINISTRI
Edi Rama



KALENDARI PËR MENAXHIMIN E SHPENZIMEVE PUBLIKE PËR VITIN 2018

PERIUDHA	DATA	INSTITUCIONI PËRGJEGJËS	VEPRIMI PËRKATËS
Janar	3	MoFE	Përgatit dhe paraqet në KM kalendarin e MSHP-së
Janar	10	KM	Shqyrton dhe miraton kalendarin e MSHP-së
Janar	15	MoFE	Paraqet në KM Kuadrin Makroekonomik e Fiskal 2019–2021
Janar	22	KM	Miraton Kuadrin Makroekonomik e Fiskal 2019–2021
Janar	29	KM	Përgatit dhe miraton projektdokumentin e prioriteteve të politikave 2019–2021 me ndikim në tavanet buxhetore
Shkurt	14	MoFE	Paraqet në KM tavanet përgatitore të përgatitjes së PBA-së 2019–2021, për fazën strategjike
Shkurt	21	KM	Shqyrton dhe miraton tavanet përgatitore të përgatitjes së PBA-së 2019–2021, për fazën strategjike
Shkurt	28	MoFE	Dërgon udhëzimin e përgatitjes së buxhetit në njësitë e qeverisjes së përgjithshme
Mars	9	KM	Paraqet për informacion në Kuvend Kuadrin Makroekonomik e Fiskal 2019–2021
Mars – prill	1 mars – 25 prill	Njësitë e qeverisjes së përgjithshme	Përgatisin kërkesat e tyre buxhetore
Mars – prill	26 prill – 27 prill	Njësitë e qeverisjes së përgjithshme	Zhvillojnë takime konsultative me shoqërinë civile për PBA-në 2019–2021
Maj	1	Njësitë e qeverisjes së përgjithshme	Paraqesin në MFE kërkesat e tyre buxhetore
Maj	2 – 16 maj	MoFE	Kryejnë analizat e kërkesave buxhetore
Maj	2 – 16 maj	KM	Analizojnë kërkesat buxhetore bazuar në dokumentin e prioriteteve të politikave 2019–2021
Maj	17 maj – 28 maj	MoFE	Organizon seancat dëgjimore me njësitë e qeverisjes së përgjithshme
Maj	29–31 maj	MoFE	Prezanton dokumentin e PBA-së, 2019–2021, me shoqërinë civile
Qershor	1	MoFE	Paraqet në KM Kuadrin Makroekonomik e Fiskal të Rishikuar (<i>në rast se shihet e nevojshme</i>)
Qershor	6	KM	Miraton Kuadrin Makroekonomik e Fiskal të Rishikuar (<i>në rast se shihet e nevojshme</i>)
Qershor	8	KM	Përgatit dhe miraton dokumentin e rishikuar të prioriteteve të politikave 2019–2021 me ndikim në tavanet buxhetore
Qershor	11 –18 qershor	MoFE	Përgatit dokumentin e PBA-së 2019–2021 dhe tavanet përfundimtare të shpenzimeve për PBA-në 2019–2021
Qershor	20	MoFE	Paraqet dokumentin e PBA-së 2019–2021 dhe tavanet përfundimtare të shpenzimeve për PBA-në 2019–2021, për shqyrtim dhe miratim në KM
Qershor	28	KM	Miraton dokumentin e PBA-së 2019–2021 dhe tavanet përfundimtare të shpenzimeve të PBA-së 2019–2021
Korrik	9	MoFE	I paraqet Kuvendit për informacion dokumentin e PBA-së 2019–2021
Korrik	10	MF	Dërgon udhëzimin plotësues të përgatitjes së buxhetit në fazën teknike, në të gjitha njësitë e qeverisjes së përgjithshme
Korrik – gusht	12 korrik – 31 gusht	Njësitë e qeverisjes së përgjithshme	Përgatisin kërkesat buxhetore të rishikuara, në përputhje me tavanet përfundimtare
Shtator	3	Njësitë e qeverisjes së përgjithshme	Paraqesin në MFE kërkesat e rishikuara buxhetore
Shtator	4–14	MoFE	Kryejnë analizat e kërkesave të rishikuara buxhetore
Shtator	4–14	KM	Analizojnë kërkesat buxhetore bazuar në dokumentin e rishikuar të prioriteteve të politikave 2019–2021
Shtator	17–26	MoFE	Organizon seancat dëgjimore me njësitë e qeverisjes së përgjithshme
Tetor	5–12	MoFE	Përgatit projektbuxhetin e vitit 2019, si dhe dokumentin e rishikuar të PBA-së 2019–2021 dhe i paraqet për shqyrtim në KM
Tetor	15	KM	Miraton projektbuxhetin e vitit 2019, si dhe dokumentin e rishikuar të PBA-së 2019–2021
Tetor	18	MF	Dërgon për informacion në Kuvend një kopje të dokumentit të rishikuar të PBA-së 2019–2021, të miratuar nga KM-ja
Tetor	18	KM	I paraqet Kuvendit projektbuxhetin e vitit 2019

**VENDIM****Nr. 14, datë 12.1.2018****PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 198, DATË 4.5.1993, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR KRIJIMIN E ENTIT KOMBËTAR TË BANESAVE”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 3, të ligjit nr. 7582, datë 13.7.1992, “Për ndërmarrjet shtetërore”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 198, datë 4.5.1993, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen ndryshimet, si më poshtë vijon:

a) Paragrafi i parë i pikës 3 ndryshohet si më poshtë vijon:

“Këshilli drejtues i EKB-së përbëhet nga 7 anëtarë:

- 1 (një) përfaqësues nga aparati i Kryeministrit;

- 2 (dy) përfaqësues nga ministria përgjegjëse për strehimin;

- 1 (një) përfaqësues nga ministria përgjegjëse për çështjet vendore;

- 1 (një) përfaqësues nga ministria përgjegjëse për infrastrukturën;

- 1 (një) përfaqësues nga ministria përgjegjëse për çështjet sociale;

- Drejtori i Përgjithshëm i Entit Kombëtar të Banesave.”.

b) Kudo në vendim, emërtimi “Ministria e Zhvillimit Urban” zëvendësohet me fjalët “... ministria përgjegjëse për strehimin ...”.

2. Ngarkohen ministria përgjegjëse për strehimin dhe Enti Kombëtar i Banesave për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM**Nr. 15, datë 12.1.2018****PËR MIRATIMIN E TARIFAVE PËR SHËRBIMET ELEKTRONIKE TË AGJENCISË KOMBËTARE TË SHOQËRISË SË INFORMACIONIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe në vijim të shkronjës “e”, të pikës 5, të kreut II, të vendimit nr. 673, datë 22.11.2017, të Këshillit të Ministrave, “Për riorganizimin e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit”, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shërbimet elektronike në favor të organeve dhe institucioneve të administratës publike dhe subjekteve private ofrohen nga Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit kundrejt aplikimit të tarifave përkatëse.

2. Tarifat, që aplikohen për shërbimet elektronike ndaj organeve dhe institucioneve të administratës publike dhe subjekteve private, janë:

a) Tarifa e kostove dhe e shërbimeve administrative për nënshkrimin elektronik, së bashku me pajisjen përkatëse;

b) Tarifa për përdorimin e modulit të administratës publike në portalin *e-Albania*, sipas shkronjës “e”, të pikës 6, të kreut II, të vendimit nr. 673, datë 22.11.2017, të Këshillit të Ministrave, “Për riorganizimin e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit”.

3. Tarifa e kostove dhe e shërbimeve administrative për nënshkrimin elektronik, së bashku me pajisjen përkatëse, mbulon kostot e shpenzimit për të gjitha shërbimet e kryera nga Agjencia, që nga momenti i paraqitjes së aplikimit, deri në momentin e marrjes së pajisjes me nënshkrim elektronik nga aplikanti.

Këto shërbime përfshijnë:

a) shkëmbimet e informacionit;

b) komunikimet postare;

c) kopjet e akteve shkresore dhe/ose elektronike;

ç) shqyrtimin dhe verifikimin e dokumentacionit të paraqitur nga aplikanti;

d) analizën paraprake;

dh) vlerësimin teknik të pajisjes;

e) gjenerimin e nënshkrimit elektronik;



ë) revokimin e certifikatës;

f) mirëmbajtjen e sistemit;

g) asistencën teknike, në rast problematikash, konfigurimesh apo humbjeje të pajisjes kriptografike (*e-Token*).

4. Tarifa e kostove dhe e shërbimeve administrative për nënshkrimin elektronik, së bashku me pajisjen përkatëse për organet dhe institucionet e administratës publike, do të ofrohet me tarifë 0 (zero) lekë.

Për subjektet private do të ofrohet me tarifë fikse prej:

- 6 400 (gjashtë mijë e katërqind) lekësh, përfshirë TVSH-në për pajisje me *usb Token*;

- 7 300 (shtatë mijë e treqind) lekësh, përfshirë TVSH-në për asistencë teknike 12-mujore.

Pagesa e kësaj tarife kryhet nga subjektet private në momentin e aplikimit *on-line* për kryerjen e veprimeve dhe procedurave, nëpërmjet pagesës elektronike në portalin *e-Albania*.

5. Të ardhurat e realizuara derdhen tërësisht në buxhetin e shtetit, në përputhje me vendimin nr. 432, datë 28.6.2006, të Këshillit të Ministrave, “Për krijimin dhe administrimin e të ardhurave, që krijohen nga institucionet buxhetore”.

6. Ngarkohet Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM
Nr. 16, datë 12.1.2018

PËR MIRATIMIN E LISTËS SË
VEPRIMTARIVE QË USHTROJNË
NDËRMARRJET SOCIALE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 10, të ligjit nr. 65/2016, “Për ndërmarrjet sociale në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Veprimtaritë e ushtruara nga ndërmarrjet sociale kontribuojnë në përmbushjen e objektivave sociale të sipërmarrjes, si: promovimi i përfshirjes sociale të kategorive në nevojë në këto veprimtari,

inkurajimi i punës vullnetare, përfshirja e të rinjve në këto veprimtari, përmirësimi i kapaciteteve të shoqërisë për të ndërmarrë veprimtari novatore, që adresojnë çështjet sociale, ekonomike dhe mjedisore.

2. Veprimtaritë e ushtruara nga ndërmarrjet sociale krijojnë mundësi të reja për punësim dhe një mjedis inkurajues për integrimin social e riintegrimin profesional të grupeve të pafavorizuara në tregun e punës.

3. Ndërmarrjet sociale e ushtrojnë veprimtarinë në nivel lokal, duke ofruar mallra e shërbime në përputhje me nevojat e komunitetit dhe në kuadër të parimit të deinstitutionalizimit të funksioneve të njësisë së qeverisjes vendore.

4. Veprimtaria e ndërmarrjeve sociale përfshin fushën e shërbimeve shoqërore, shëndetësore, kulturore e arsimore, të promovimit të turizmit e mbrojtjes mjedisore, si dhe veprimtari të ndërmjetësimit e kualifikimit për punësim. Këto veprimtari zhvillohen si më poshtë vijon:

a) Në fushën e shërbimeve shoqërore, veprimtari që lidhen me shërbime të kujdesit shoqëror, të cilat ofrohen në qendrat rezidenciale, qendrat ditore, në shtëpi dhe në komunitet, sipas parashikimeve ligjore përkatëse;

b) Në fushën e shërbimeve shëndetësore, veprimtari për mbrojtjen dhe promovimin e shëndetit, të aktiviteteve fizike e sporteve amatore, për qëllim socializimi e argëtimi;

c) Në fushën e promovimit të turizmit, shërbime në bar-restorante-hoteleri, guida turistike dhe shërbime të turizmit social për personat, të cilët nuk kanë mundësi të vizitojnë atraksionet turistike për shkak të kushteve shëndetësore ose të jetesës;

ç) Në fushën e veprimtarive kulturore, veprimtari që lidhen me artin, trashëgiminë kulturore dhe aktivitete të tjera të kësaj natyre;

d) Në fushën e mbrojtjes mjedisore, veprimtari që lidhen me ruajtjen e mjedisit nga ndotja e dëmtimi nga aktiviteti njerëzor dhe veprimtaritë ekonomike, për të garantuar një mjedis të shëndetshëm për qytetarët;

dh) Në fushën e kualifikimit dhe të ndërmjetësimit për punësim, veprimtari për promovimin e trajnimit profesional, veprimtari edukative e të ndërmjetësimit për punësim për personat që përfshihen në kategoritë e grupeve të pafavorizuara.



5. Ndërmarrjet sociale kryejnë edhe veprimtari tregtimi mallrash apo shërbimesh, të ofruara nga veprimtari të ndërmarrjeve të tjera sociale, produkte për personat e pafavorizuar, produkte të prodhuesve të vegjël nga zona të thella apo të pafavorshme nga ana mjedisore, si dhe të tjera veprimtari në mbështetje të ndërmarrjeve të tjera sociale.

6. Në fushën e prodhimit, ndërmarrjet sociale kryejnë veprimtari që lidhen me prodhimin artizanal të një game të gjerë mallrash e produkteve që i shërbejnë komunitetit dhe, veçanërisht, produkteve që kanë për qëllim krijimin e lehtësive për personat e pafavorizuar.

7. Ngarkohet Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM
Nr. 17, datë 12.1.2018

**PËR FINANCIMIN E SHËRBIMEVE
SHËNDETËSORE SPITALORE NGA
SKEMA E DETYRUESHME E
SIGURIMEVE TË KUJDESIT
SHËNDETËSOR PËR VITIN 2018**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 5, të ligjit nr. 109/2017, “Për buxhetin e vitit 2018”, dhe të nenit 10, të ligjit nr. 10383, datë 24.2.2011, “Për sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Financimin nga skema e detyrueshme e sigurimeve shëndetësore të paketës së shërbimeve të ofruara në spitalet publike, sipas listës së shërbimeve, të dhënë në shtojcën nr. 1 që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Spitali është person juridik, publik, me buxhet të pavarur, me cilësinë e autoritetit kontraktor, i cili organizohet, administrohet dhe vepron sipas ligjit nr. 9106, datë 17.7.2003, “Për shërbimin spitalor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

3. Spitali e ushtron veprimtarinë e tij në përputhje me standardet, treguesit e cilësisë e të performancës, protokollet e diagnozës e të trajtimit, të miratuara nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

4. Buxheti për mbulimin e paketës së shërbimeve spitalore, sipas listës së shërbimeve që ofron çdo spital, ndahet sipas shtojcës nr. 2 që i bashkëlidhet këtij vendimi.

5. Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor lidh kontratat me spitalet për financimin e paketave të shërbimeve shëndetësore të ofruara prej tyre.

6. Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor financon paketën e shërbimeve spitalore të kontraktuara me metodat e mëposhtme:

a) Buxhetim me zëra shpenzimesh, për:

i) paga dhe shpenzime të tjera lidhur me pagën e personelit;

ii) kontribute për sigurime shëndetësore e shoqërore të personelit;

iii) mallra e shërbime të tjera;

b) Buxhetim global për pagesën e paketave të shërbimeve me çmime të miratuara me vendim të Këshillit të Ministrave. Buxhetimi global detajohet për çdo spital në zëra shpenzimesh me vendim të Këshillit Administrativ të Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor.

7. Spitali është përgjegjës për zbatimin e buxhetit të kontraktuar, sipas zërave të përcaktuar në buxhet.

8. Rishpërndarja e buxhetit ndërmjet spitaleve bëhet brenda një kufiri prej 3% të buxhetit të spitaleve, me vendim të Këshillit Administrativ të Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor.

9. Një fond jo më i madh se 25% e buxhetit vjetor, i planifikuar për shërbimet spitalore, mbahet nga Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor për ta shpërndarë gjatë vitit, me vendim të Këshillit Administrativ të Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor, për:

a) financimin e shërbimit spitalor gjatë vitit;

b) pagesat e paketave të shërbimeve të veçanta, të ofruara nga shërbimet spitalore, publike e jopublike, brenda e jashtë vendit, të miratuara me vendim të Këshillit të Ministrave;



c) pagesat për kujdes shëndetësor në institucione jopublike, brenda e jashtë vendit, sipas miratimit, rast pas rasti, me vendim të Këshillit të Ministrave;

ç) pagesat për kujdes shëndetësor, sipas marrëveshjeve ndërkombëtare të nënshkruara;

d) pagesa të shërbimeve të kryera për llogari të spitaleve publike nga operatorë të kontraktuar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, sipas legjislacionit për partneritetin publik privat;

dh) transferta për individët (mjekë specialistë).

10. Shpenzimet kapitale për investimet në spitale mbulohen nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

11. Burime të tjera financimi për spitalet janë fondet e krijuara nga të ardhurat e realizuara gjatë veprimtarisë së tyre dhe nga dhurimet. Përdorimi i tyre bëhet totalisht nga vetë spitali, si pjesë e kostos së shërbimit, bazuar në procedurat e miratuara nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale. Këto të ardhura vlerësohen si të ardhura jashtë limitit.

12. Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, për raste të vlerësuara nga ajo ose me kërkesë të autoriteteve kontraktuese (spitaleve), mund të zhvillojë procedura të përqendruara prokurimi për disa mallra, shërbime e investime.

13. Spitali zbaton sistemin e referimit dhe tarifat për shërbimet me pagesë, të miratuara nga ministri i Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

14. Mënyra e pagesës dhe e shpërblimit të punës së punonjësve të spitaleve, që kanë lidhur kontratë me Fondin e Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor, sipas këtij vendimi, përcaktohet me vendim të Këshillit Administrativ të Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor.

15. Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale auditon spitalin, nëpërmjet strukturës së saj audituese, për zbatimin e standardeve të miratuara prej saj dhe për raste të tjera me urdhër të ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

16. Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor kontrollon dhe monitoron spitalin për buxhetin dhe aktivitetin vjetor, sipas kushteve të përcaktuara në kontratën dypalëshe.

17. Marrëdhëniet juridike të punës në spitale rregullohen në përputhje me ligjin nr. 7961, datë 12.7.1995, “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

18. Numri i përgjithshëm i punonjësve të spitaleve është 12 016 (dymbëdhjetë mijë e gjashtëmbëdhjetë) veta, nga të cilët 141 punonjës në Spitalin Universitar të Traumës për Shërbimin e Urgjencës Ambulatore dhe Shërbimin e Ortopedi-Traumatologjisë. Numri dhe struktura e punonjësve, për çdo spital, miratohen nga ministri i Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

19. Për raste të veçanta të mungesës së mjekut specialist në shërbime të ndryshme të spitaleve rajonale e bashkiake, ministri i Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, brenda numrit të përgjithshëm të personelit spitalor, urdhëron kontraktimin, për një periudhë të caktuar, të mjekëve specialistë, sipas nevojave. Këta mjekë të specialiteteve të ndryshme, përveç pagës, trajtohen financiarisht me një bonus deri në 250 000 (dyqind e pesëdhjetë mijë) lekë në muaj. Vlera e bonusit përcaktohet, rast pas rasti, nga ministri i Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale. Ky bonus, për efekt të llogaritjes së kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, trajtohet sipas shkronjës “e”, të pikës 2, të kreut II, të vendimit nr. 77, datë 28.1.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për kontributet e detyrueshme dhe përfitimet nga sistemi i sigurimeve shoqërore dhe sigurimi i kujdesit shëndetësor”, të ndryshuar.

20. Mjekët e kontraktuar, sipas pikës 18 të këtij vendimi, nuk e përfitojnë shpërblimin sipas shkronjave “a” dhe “b”, të pikës 9/1, të vendimit nr. 555, datë 11.8.2011, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e strukturës dhe nivelit të pagave të punonjësve me arsim të lartë në sistemin e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Spitalin Ushtarak Qendror Universitar, të punonjësve të infermieristikës në sistemin e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Ministrisë së Mbrojtjes, si dhe për trajtimin e mjekëve në strukturat e Forcave të Armatosura”, të ndryshuar.

21. Numri i pedagogëve me kontratë shërbimi për spitalet universitare miratohet nga ministri i Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale. Pagesa e tyre bëhet nga buxheti i spitalit.

22. Financimi i institucioneve dhe i shërbimeve, të përcaktuara në shtojcën nr. 3 që i bashkëlidhet këtij vendimi, bëhet nga Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor, vetëm kundrejt shtesave përkatëse në buxhet, nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

23. Vendimi nr. 18, datë 18.1.2017, i Këshillit të Ministrave, “Për financimin e shërbimeve



shëndetësore spitalore nga skema e detyrueshme e sigurimeve të kujdesit shëndetësor për vitin 2017”, i ndryshuar, shfuqizohet.

24. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i fillon efektet nga data 1 janar 2018.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

SHTOJCA NR. 1

LISTA E SHËRBIMEVE SPITALORE QË DO TË FINANCOHEN NGA FONDI I SIGURIMIT TË DETYRUESHËM TË KUJDESIT SHËNDETËSOR

I. SPITALET UNIVERSITARE

1. Shërbimi i kardiologjisë;
 - a) Hemodinamika;
 - b) Reanimacioni i kardiologjisë.
2. Shërbimi i kardiokirurgjisë;
3. Shërbimi i kirurgjisë angiovaskulare;
4. Shërbimi i hematologjisë;
5. Shërbimi i gastrohepatologjisë;
6. Shërbimi i endokrinologjisë;
7. Shërbimi i nefrologjisë dhe hemodializës;
8. Shërbimi i anestezi-së-reanimacionit;
9. Shërbimi i urgjencës së sëmundjeve të brendshme;
10. Shërbimi i mjekësisë interne;
11. Shërbimi i alergologjisë;
12. Shërbimi i reumatologjisë;
13. Shërbimi i dermatologjisë;
14. Shërbimi i traumatologjisë;
15. Shërbimi i ortopedisë (SU “Trauma”);
16. Shërbimi i okulistikës;
17. Shërbimi i ORL-së;
18. Shërbimi i kirurgjisë maksilo-faciale;
19. Shërbimi i urgjencës kirurgjikale;
20. Shërbimi i kirurgjisë digjестive;
21. Shërbimi i urologjisë;
22. Shërbimi i djegie-plastikës;
23. Shërbimi i neurologjisë neurofiziollogjisë dhe neurovaskular;
24. Shërbimi i neurokirurgjisë;

25. Shërbimi i onkologjisë+kirurgjia onkologjike + radioterapi;

b) Laboratori histopatologjik onkologjik;

c) Laboratori klinik-biokimik onkologjik;

26. Shërbimi infektiv;

27. Shërbimi i pediatri-së së përgjithshme:

a) Urgjenca pediatrike;

b) Fizioterapia pediatrike;

28. Shërbimi i pediatri-së së specialiteteve;

29. Shërbimi i pediatri-së infektive;

30. Shërbimi i kirurgjisë infantile;

31. Shërbimi i onkohematologjisë pediatrike;

32. Shërbimi i reanimacionit pediatrik;

33. Shërbimi i laboratorëve (klinikë-biokimikë, mikrobiologjikë, imunologjikë, atomopatologjikë, gjenetikë mjekësore, laborator i mjekësisë nukleare);

34. Shërbimi i imazherisë;

35. Shërbimi i fizioterapisë;

36. Shërbimi i statistikave;

37. Shërbimi i pneumologjisë;

38. Kirurgjia torakale;

39. Shërbimi i fizioatri-së;

40. Shërbimi i gjinekologjisë;

41. Shërbimi i obstetrikës;

42. Shërbimi i patologjisë së barrës;

43. Shërbimi i neonatologjisë;

44. Shërbimi i farmacisë;

45. Shërbimi i konsultave të specializuara ambulatorë;

46. Shërbimi i toksikologjisë;

47. Shërbimi i psikiatri-së (QSUT);

48. Kontrolli i infeksioneve spitalore;

49. Shërbimi i urgjencës ambulatorë.

II. SPITALET NË NIVEL QARKU (SPITALET RAJONALE)

Spitalet publike të qarkut ofrojnë shërbimet e:

1. Urgjencës;

2. Mjekësisë së përgjithshme;

3. Kirurgjisë së përgjithshme, ortopedi-traumatologji, urologji, ORL, okulistikë, angiologji, max-facial;

4. Obstetrikë-gjinekologjisë;

5. Neonatologji;

6. Pediatri-së;

7. Radiologjisë;

8. Fizioterapisë;

9. Anatomisë dhe histologjisë patologjike;

10. Laboratorëve klinikë-biokimike e të mikrobiologjisë;



11. Anestezi-reanimacionit;
12. Farmacia;
13. Shërbimin e onkologjisë (kimioterapisë, kujdesin paljativ);
14. Kontrolli i infeksioneve spitalore;
15. Shërbime psikosocial;
16. Shërbimi i konsultave të specializuara (poliklinika specialitetesh)
17. Banka e gjakut.

III. SPITALET NË NIVEL BASHKIE

Spitalet publike të përgjithshme në nivel bashkie ofrojnë shërbimet e:

1. Urgjencës;
2. Mjekësisë së përgjithshme;
3. Kirurgjisë së përgjithshme;
4. Pediatrikë dhe obstetrikë-gjinekologjisë, neonatologji;
5. Radiologjisë;
6. Laboratorëve kliniko-biokimike e të mikrobiologjisë;
7. Anestezi-reanimacionit;
8. Farmacisë;
9. Shërbimin ambulator të specializuar;
10. Banka e gjakut.

Trajtimi i kimioterapisë do të jetë në pesë spitale: Durrës, Vlorë, Shkodër, Korçë, Spitali Universitar “Shefqet Ndroqi”.

IV. SPITALET DITORE

1. Ndihmë e parë mjekësore për trajtim dhe kurim brenda 24 orëve.



SHTOJCA NR. 2

BUXHET 2018								
BUXHETI I SHERBIMIT SPITALOR 2017								
000 LEKE								
Nr	SPITALET	buxhet 2018						total
		6000000	6010000	6020000	60400000	6060000	rezerve e pashpemd are	
1	BERAT	252,800	41,950	162,000				456,750
2	BULQIZË	69,900	11,400	25,500				106,800
3	DELVINË	30,650	4,900	5,500				41,050
4	DEVOLL	43,950	7,250	10,000				61,200
5	DIBËR	226,500	36,900	110,000				373,400
6	ELBASAN	388,500	64,050	220,000				672,550
7	FIER	335,000	55,650	170,000				560,650
8	GRAMSH	102,000	16,850	36,000				154,850
9	GJIROKASTËR	178,300	29,050	80,000				287,350
10	HAS	37,000	5,950	12,000				54,950
11	KAVAJË	100,500	16,450	28,000				144,950
12	KOLONJË	77,900	12,500	20,000				110,400
13	KORCË	368,300	60,950	185,000				614,250
14	KRUJË	110,200	17,900	25,000				153,100
15	KUÇOVË	59,000	9,400	30,000				98,400
16	KUKËS	210,000	34,750	100,000				344,750
17	KURBIN	74,500	12,400	28,000				114,900
18	LEZHË	210,000	34,750	110,000				354,750
19	LIBRAZHD	126,800	20,750	50,000				197,550
20	LUSHNJË	198,500	32,750	100,000				331,250
21	MALËSI E MADHE	20,220	3,400	6,000				29,620
22	MALLAKASTËR	36,820	6,050	11,000				53,870
23	MAT	106,000	17,700	30,000				153,700
24	MIRDITË	90,850	14,750	25,000				130,600
25	PEQIN	31,500	5,200	5,500				42,200
26	PËRMET	74,400	12,250	35,000				121,650
27	POGRADEC	148,500	24,450	70,000				242,950
28	PUKË	83,400	13,250	30,000				126,650
29	SARANDË	132,800	21,600	95,000				249,400
30	SKRAPAR	75,500	12,450	16,000				103,950
31	SHKODËR	470,000	77,300	180,000				727,300
32	TEPELENË	81,000	13,450	16,000				110,450
33	QSUT	1,840,000	302,700	3,323,000				5,465,700
34	SUOGJ "MBRETËRESHL	273,300	43,550	250,000				566,850
35	SUOGJ "KOÇO GLIOZHI	219,000	35,400	160,000				414,400
36	SU "SHEFQET NDROQI	282,400	46,950	300,000				629,350
37	TROPOJE	88,700	14,400	35,000				138,100
38	VLORE	360,000	59,800	270,000				689,800
39	SU TRAUMA	105,900	16,950	120,000				242,850
	Paketat e shërbimeve				2,203,750			2,203,750
	Trajtime me VKM				50,000			50,000
	Transferta për individët (mjekë specialistë)					52,000		52,000
	Pagesa të shërbimeve PPP				1,870,000			1,870,000
	Rezerve						244,010	244,010
	TOTALI	7,720,590	1,268,150	6,484,500	4,123,750	52,000	244,010	19,893,000



SHTOJCA NR. 3
LISTA E INSTITUCIONEVE QË NUK DO
TË FINANCOHEN NGA FONDI I
SIGURIMIT TË DETYRUESHËM TË
KUJDESIT SHËNDETËSOR

1. Spitali psikiatrik Vlorë;
2. Spitali psikiatrik Elbasan;
3. Shërbimet e shëndetit mendor në rrethe;
4. Shërbimi i psikiatrisë Shkodër;
5. Qendra Kombëtare e Ri aftësimit, Mirërritjes dhe Zhvillimit të Fëmijëve;
6. Shërbimi Kombëtar i Transfuzionit;
7. Qendra Kombëtare Biomjekësore.

VENDIM
Nr. 19, datë 12.1.2018

PËR MBULIMIN E PJESSHËM
TË SHPENZIMEVE TË MJEKIMIT
TË Z. MOIKOM ZEKO

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të ligjit nr. 109/2017, “Për buxhetin e vitit 2018”, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Mbulimin e pjesshëm të shpenzimeve të mjekimit të z. Moikom Zeqo, në masën 2 500 000 (dy milionë e pesëqind mijë) lekë.
2. Ky fond të përballohet nga Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor.
3. Pagesa të bëhet me paraqitjen e faturave të përkatëse të mjekimit.
4. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM
Nr. 20, datë 12.1.2018

PËR MBULIMIN E PJESSHËM
TË SHPENZIMEVE TË MJEKIMIT
TË Z. LEONARDO FRROKAJ

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të ligjit nr. 109/2017, “Për buxhetin e vitit 2018”, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Mbulimin e pjesshëm të shpenzimeve të mjekimit z. Leonardo Frrokaj, në masën 2 000 000 (dy milionë) lekë.
 2. Ky fond të përballohet nga Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor.
 3. Pagesa të bëhet me paraqitjen e faturave të përkatëse të mjekimit.
 4. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM
Nr. 21, datë 12.1.2018

PËR DISA SHITESA NË VENDIMIN
NR. 709, DATË 29.10.2014, TË KËSHILLIT
TË MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E
STRATEGJISË NDËRSEKTORIALE PËR
ZHVILLIMIN RURAL DHE BUJQËSOR
2014–2020”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 4, të ligjit nr. 9817, datë 22.10.2007, “Për bujqësinë dhe zhvillimin rural”, me propozimin e ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, ministrit të Turizmit dhe Mjedisit, ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë si dhe të ministrit të Kulturës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në Strategjinë Ndërsektorale për Zhvillimin Rural dhe Bujqësor 2014–2020, që i bashkëlidhet vendimit nr. 709, datë 29.10.2014, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto shtesa:



a) Pas nënndarjes 3.5.2 të pikës 3 shtohen nënplikat 3.6 dhe 3.7, me këtë përmbajtje:

“3.6. Programi i Integruar për Zhvillimin Rural – Programi i 100 fshatrave

i) Qëllimi i programit

Programi i Integruar për Zhvillimin Rural (PIZHR) – Programi i 100 fshatrave synon të koordinojë ndërhyrjet zhvillimore në hapësirën rurale të 100 fshatrave, përcaktuar në shtojcën B të kësaj strategjie, sipas qasjes ndërsektoriale dhe me shumë aktorë, duke u shkëputur nga ndërhyrjet e copëzuara dhe me qasje strikte sektoriale, që po ndodhin apo pritet të ndodhin në vend.

Qasja e integruar për zhvillimin rural do të targetojë objektiva të matshëm për zhvillimin e hapësirës rurale, nëpërmjet fokusit të qendëruar (programim i integruar dhe i koordinuar) i investimeve publike, atyre të donatorëve dhe i investimeve private, në hapësirën e mirëpërcaktuar të 100 fshatrave, me potenciale të larta zhvillimi ekonomiko-sociale, të agroturizmit e turizmit rural, natyrës dhe mjedisit, si dhe të trashëgimisë kulturore.

ii) Objektivat e programit

PIZHR-ja do të programojë ndërhyrjet me investime të integruara në zonat e përcaktuara (100 fshatra), nëpërmjet 3 objektiveve, si më poshtë vijon:

a) Përmirësimi i infrastrukturës publike (mbështetje për infrastrukturë rrugore, rivitalizime hapësirash publike/urbane, infrastrukturë

komunitare, shërbime publike, infrastrukturë mjedisore, turistike, monumente të trashëgimisë kulturore, qendra multifunksionale komunitare, peizazhi mjedisor etj.);

b) Zhvillimi ekonomik nëpërmjet diversifikimit të aktiviteteve ekonomike (përmirësimi i potencialit turistik në hapësirat rurale, agroturizëm dhe turizëm rural, investimet në përmirësimin e shërbimeve tregtare, investime në prodhimin e produkteve tradicionale dhe shërbime të tjera ekonomiko-financiare etj. Mbështetja për inkubatorë të produkteve rurale tradicionale, promovim dhe marketim të zonave rurale, shërbime transporti, panairë dhe festat lokale etj.);

c) Zhvillim i kapitalit social dhe njerëzor (mbështetje për krijimin e rrjeteve rurale, grupeve lokale të veprimit, si dhe shoqërinë civile në zonat rurale, trajnim profesional për të rinjtë dhe gratë, mbështetje të trashëgimisë kulturore, mbështetje për promovimin e traditave dhe të jetesës në fshat etj.).

3.6.1. Kohëzgjatja e programit

Programi i Integruar për Zhvillimin Rural – Programi i 100 fshatrave, do të zbatohet në periudhën 2018–2020.

3.6.2. Impakti (indiktorët)

Impakti i përgjithshëm që synon të arrijë Programi i Integruar për Zhvillimin Rural (PIZHR) do të matet me treguesit e matshëm, si më poshtë. Në hapësirën e përcaktuar të 100 fshatrave, PIZHR-ja synon të arrijë:

Treguesit	2018	2019	2020	TOTAL 2018–2020
Numrit i vendeve të reja të punës	100	200	300	600
Nr. i të punësuarve gra/vajza	30	50	100	180
Nr. i të punësuarve të rinj (22–35 vjeç)	50	50	100	200
Nr. i bizneseve të reja (<i>start up</i>) të mbështetura për të rinj	50	50	50	150
Nr. i bujtinave të mbështetura	50	50	50	150
Nr. i inkubatorëve të ngritur të produkteve tradicionale	5	10	20	25
Nr. i mbështetur i sipërmarrjeve të reja të agroturizmit	7	10	10	27
Nr. i sipërmarrjeve prodhuese të produkteve tradicionale	10	15	25	50
Nr. i projekteve të realizuara të përmirësimit të infrastrukturës dhe shërbimeve publike	30	70	100	200



3.6.3. Administrimi i Programit të Integruar për Zhvillimin Rural (PIZHR) – Programi i 100 fshatrave

Për zbatimin e këtij programi, bazuar në qasjen ndërsektoriale dhe me shumë aktorë, do të krijohen struktura të posaçme të cilat do të bëjnë të mundur administrimin, bashkërendimin, koordinimin, zbatimin dhe monitorimin e programit të 100 fshatrave, sipas ndarjes së qartë të roleve dhe të autoritetit përkatës. Gjatë gjithë zbatimit të programit, autoritetet koordinuese kujdesen për përfshirjen e donatorëve dhe shoqërisë civile, në veçanti në Rrjetin Kombëtar për Zhvillim Rural dhe grupeve lokale të veprimit (GLV).

3.6.4. Zbatimi

Projektet e financuara në kuadër të programit të 100 fshatrave do të zbatohen kryesisht nga bashkitë, si dhe agjenci të tjera publike (agjencitë e zhvillimit rajonal 1, 2, 3 dhe 4, Agjencia për Zhvillimin Ekonomik Rajonal, Agjencia Kombëtare e Turizmit, FSHZH-ja, MADA etj.).

Programi do të mbështesë edhe projekte të propozuara nga organizatat e shoqërisë civile (OJF), individë, fermerë, persona juridikë etj., në përputhje me legjislacionin në fuqi.

3.6.5. Financimi i programit

Programi i 100 fshatrave mund të financohet nga buxhetet e ministrive pjesëmarrëse në program. Në detajimin e fondeve për investime, të alokuara në buxhetet respektive të ministrive apo të institucioneve të tyre të varësisë, ministrinë pjesëmarrëse në program do të synojnë t'u japin përparësi projekteve të identifikuar dhe që zbatohen në zonën e përcaktuar të 100 fshatrave.

Projektet e identifikuar në kuadër të programit të 100 fshatrave mund të financohen edhe nga Fondi i Zhvillimit të Rajoneve, sipas kriterëve dhe rregullave të përcaktuara nga Komiteti për Zhvillimin e Rajoneve.

Ministrinë pjesëmarrëse mund të nënshkruajnë marrëveshje bashkëpunimi për grante, për financimin e këtij programi nga donatorë dhe me financim të huaj.

Programi mund të financohet nga çdo burim tjetër i ligjshëm apo nëpërmjet mekanizmave të partneritetit publik privat.

3.6.6. Përfituesit

Përfitues nga programi i 100 fshatrave janë popullsia e zonave rurale, fermerët dhe grupet e

fermerëve, individë, në veçanti gratë dhe të rinjtë, persona juridikë, bashkitë, organizatat jofitimprurëse, shoqëritë e bashkëpunimit bujqësor etj.

3.6.7. Projektet strategjike

Në kuadër të programit të 100 fshatrave janë identifikuar 3 projekte strategjike të cilat do të zbatohen me prioritet të lartë:

i) Krijimi i rrjetit të agroturizmit shqiptar

Agroturizmi dhe turizmi rural janë veprimtari të cilat kanë një potencial të lartë zhvillimi për zonat rurale në Shqipëri dhe tashmë në shumë fshatra të Shqipërisë kanë filluar të funksionojnë ferma që ofrojnë shërbime në agroturizëm dhe kanë arritur në një kohë të shkurtër rezultate shumë të mira ekonomike dhe sociale (Thethi, Voskopoja, Dardha etj.).

Në kuadër të programit të 100 fshatrave do të mbështetet me instrumente financiare dhe fiskale krijimi i një rrjeti fermash agroturistike, që plotësojnë kriteret dhe standardet e përcaktuara, të cilat do të jenë baza e rrjetit shqiptar të agroturizmit. Mbështetja për të krijuar një masë kritike të numrit të sipërmarrjeve të agroturizmit në Shqipëri do të shërbejë për rritjen e punësimit në zonat rurale, krijimin e një destinacioni dhe “marke” të veçantë të agroturizmit në Shqipëri, krahas ofertave të tjera turistike, si dhe ruajtjen e trashëgimisë kulturore dhe vlerave tradicionale të fshatit shqiptar.

Programi do të synojë mbështetje për rreth 27 sipërmarrje agroturizmi të reja dhe 150 bujtina. Mbështetja do të synojë, gjithashtu, edhe përmirësimin e fermave dhe staneve blegtorale për qëllime të veprimtarisë së agroturizmit dhe turizmit rural.

ii) Rrjeti i inkubatorëve të produkteve tradicionale

Shqipëria ka potenciale të mëdha dhe të shumta në prodhimin e produkteve ushqimore tradicionale. Produktet tradicionale shqiptare të prodhuara në mënyra artizanale, pavarësisht nga vlerat e mëdha dhe të interesit të konsumatorit vendës dhe të huaj, kanë treguar që depërtojnë me vështirësi në tregje për shkak të shkallës së vogël ekonomike që rrisin kostot për njësi të prodhimit, sasive të limituara të prodhimit, si dhe të kërkesave të larta ligjore për standardet e ushqimit dhe ato higjieno-sanitare. Këto vështirësi, kombinuar edhe me njohuritë e pakta dhe mundësitë/kapitalet e vogla që



disponojnë prodhuesit e vegjël të produkteve tradicionale, rrezikojnë që në një periudhë afatmesme/afatgjatë këto produkte të humbasin dhe të eliminohen nga tregu dhe tryezat e shqiptarëve. Përveçse një dëm që mund t'u krijohet prodhuesve të vegjël nga zonat rurale, dëmi më i madh mund t'u bëhet traditave dhe trashëgimisë kulturore shqiptare.

Në këtë kontekst, programi do të synojë të krijojë rrjetin e inkubatorëve të produkteve tradicionale, që do të jenë hapësira që ofrojnë infrastrukturë të gatshme për të gjithë zinxhirin e vlerës së produktit, duke filluar që nga ambientet dhe pajisjet e prodhimit/magazinimit, linjave të paketimit dhe të marketimit, mbështetje për standardizimin e certifikimin, si dhe hapësirë për shitje të produkteve.

Inkubatorët do të ofrojnë mbështetje për prodhuesit e vegjël të zonave rurale, në veçanti grave dhe të rinjve, të cilët mund të shfrytëzojnë inkubatorin për prodhimin, paketimin, marketimin, standardizimin dhe shitjen e produkteve të tyre, kundrejt një pagese të lehtësuar dhe të përbalueshme për shërbimet që ofron inkubatori.

iii) Rrjeti i markatave/dyqaneve të produkteve shqiptare dhe tradicionale

Produktet tradicionale shqiptare kanë treguar që e kanë të vështirë depërtimin në tregjet dhe dyqanet e shitjes me pakicë, për shkaqet e shpjeguara në nënpikën “ii”. Në mbështetje të hallkës së fundit të zinxhirit të vlerës (shitja), programi do të synojë që të krijojë një rrjet të markatave/dyqaneve që do të jenë të specializuara në shitjen e produkteve shqiptare, në veçanti produkteve tradicionale. Do të synohet që ky rrjet të ketë emërtimin e tij (markën/*brand-in*) që e dallon nga rrjetet e tjera dhe bazuar në një strategji të posaçme marketingu dhe *franchise*, do të mund të krijojë një masë kritike të dyqaneve që do të bëjnë të mundur rritjen e përqindjes së shitjes së produkteve shqiptare/tradicionale. Mbështetja financiare për ngritjen e këtij rrjeti do të parashikohet në kuadrin e programit të 100 fshatrave.

3.7 Autoriteti administrues

Për administrimin e Programit të Integruar për Zhvillimin Rural (PIZHR) – Programi i 100 fshatrave, krijohet Komisioni Ndërmintor për Programin e 100 Fshatrave, dhe me përbërje të ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, ministrit të Turizmit dhe Mjedisit, ministrit të

Infrastrukturës dhe Energjisë, si dhe ministrit të Kulturës.

3.7.1. Komisioni Ndërmintor për Programin e 100 Fshatrave

Komisioni Ndërmintor mbledhet rregullisht për të vendosur për ecurinë e programit, por jo më pak se 1 herë në tre muaj. Komisioni, si autoriteti më i lartë vendimmarrës i programit, vendos për të gjitha çështjet që lidhen me administrimin, programimin, financimin, zbatimin dhe monitorimin e programit. Komisioni, në veçanti, vendos për:

- shqyrtimin dhe miratimin e planeve të zhvillimit të fshatrave dhe projektideve, që i paraqiten komisionit për mbështetje nga programi i 100 fshatrave;

- propozimin për masën e financimeve vjetore për programin e 100 fshatrave, nga buxhetet e ministrive pjesëmarrëse në program dhe/ose ministrive të tjera, si dhe nga FZHR-ja;

- marrëveshjet e bashkëpunimit me donatorë dhe partnerë të tjerë, për mbështetjen e programit të 100 fshatrave;

- miratimin e raportit të progresit të zbatimit të programit;

- çdo çështje tjetër që lidhet me administrimin e programit.

Për një koordinim dhe bashkërendim më të mirë të programit, komisioni zhvillon takime konsultuese me bashkitë dhe me komunitetin e donatorëve.

Për zbatimin e këtij programi, komisioni bashkëpunon në veçanti me bashkitë dhe agjencitë rajonale të zhvillimit, si dhe me partnerë të tjerë publikë apo privatë, që janë të interesuar për të mbështetur programin e 100 fshatrave.

Gjatë zbatimit të këtij programi, komisioni mbështetet në parimet e qasjes *LEADER*, duke garantuar një bashkëpunim të ngushtë me organizatat jofitimprurëse aktive në fushën e zhvillimit rural dhe me Rrjetin Kombëtar për Zhvillimin Rural. Në zbatim të Strategjisë Ndërsektoriale të Zhvillimit Rural dhe Bujqësisë 2014–2020, komisioni nëpërmjet programit do të nxisë krijimin e grupeve lokale të veprimt (GLV) dhe financimin e projekteve të propozuara nga to.

3.7.2. Sekretariati teknik

Për një administrim sa më të mirë të këtij programi, komisioni mbështetet nga sekretariati



technik që krijohet pranë Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, me urdhër të ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural. Sekretariati teknik kryen detyra ndihmëse dhe administrative.

Ministritë pjesëmarrëse në program caktojnë personat e tyre të kontaktit (në nivel drejtuesi të ministrisë), që janë ura lidhëse ndërmjet sekretariatit teknik dhe ministrive përkatëse.

Sekretariati teknik kryen këto detyra:

- Përgjigjet për organizimin dhe për mbajtjen e procesverbaleve të mbledhjeve të komisionit;
- Përgatit materiale dhe raporte me shkrim për ecurinë e zbatimit të programit;
- Informon dhe koordinon punën me institucionet publike, bashkitë, agjencitë zbatuese, si dhe me partnerë të tjerë, në zbatim të detyrave të përcaktuara nga komisioni;
- Kujdeset për administrimin e faqes së internetit të programit të 100 fshatrave;
- Kujdeset për informimin publik dhe transparencën e programit të 100 fshatrave;
- Ky sekretariat kryen çdo detyrë tjetër që i ngarkohet nga komisioni.”.

b) Pas shtojcës A shtohet shtojca B, sipas tabelës bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Ngarkohen Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë si dhe Ministria e Kulturës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama



SHTOJCA B

QARKU	BASHKIA	FSHATI	TOTAL
BERAT	Bashkia Berat	Qafë Dardhë	1
		Roshnik	1
	Bashkia Ura-Vajgurore	Malas Breg	1
	Bashkia Kuçovë	Kozare	1
	Bashkia Skrapar	Blezëncë	1
DIBËR	Bashkia Polican	Kapinovë	1
		Rabdisht	1
	Bashkia Mat	Radomirë	1
		Bushkash	1
		Zerqan	1
DURRËS	Bashkia Klos	Gur i Bardhë	1
		Shetaj	1
		Shënavlash	1
	Bashkia Shijak	Radë	1
		Gjepalaj/Eminas	1
ELBASAN	Bashkia Krujë	Metallaj	1
		Halilaj (Zgërdhesh)	1
	Bashkia Elbasan	Gjinar	1
		Shushicë	1
	Bashkia Cërrik	Shtermenj	1
	Bashkia Belsh	Seferan	1
	Bashkia Gramsh	Sotirë	1
	Bashkia Peqin	Pajovë	1
FIER	Bashkia Librazhd	Stëblevë	1
		Dardhë	1
	Bashkia Prrenjas	Rrajcë/Skënderbej	1
		Pojan	1
	Bashkia Fier	Libofshë	1
		Cakran	1
	Bashkia Patos	Siceqë	1
	Bashkia Roskovec	Luar	1
GJIROKASTËR	Bashkia Lushnjë	Ardenicë	1
		Krutje	1
	Bashkia Divjakë	Goricaj	1
	Bashkia Mallakastër	Hekal	1
		Dhoksat	1
	Bashkia Gjirokastër	Zhulat	1
		Antigone	1
	Bashkia Libohovë	Lazarat	1
		Labovë e Sipërme	1
	Bashkia Tepelenë	Nepravishtë	1
		Nivicë	1
	Bashkia Memaliaj	Peshtan	1
GJIROKASTËR	Bashkia Përmet	Kalivaç	1
		Kosinë	1
	Bashkia Këlcyre	Leusa	1
		Maleshovë	1
	Bashkia Dropull	Sotirë	1



SHTOJCA B

KORÇË	Bashkia Korçë	Drenovë/Boboshticë	1	
		Voskopojë	1	
		Dardhë	1	
		Bashkia Maliq	Zvininë	1
	Bashkia Kolonjë	Rehovë	1	
		Borovë	1	
	Bashkia Pogradec	Lin	1	
		Tushemisht	1	
		Gurras	1	
	Bashkia Devoll	Arrëz	1	
		Nikolicë	1	
	Bashkia Pustec	Zaroshkë	1	
	KUKËS	Bashkia Kukës	Shishtavec	1
Shtiqen			1	
Bashkia Has		Cahan	1	
Bashkia Tropojë		Valbonë	1	
LEZHË	Bashkia Lezhë	Ishull-Lezhë	1	
		Fishtë	1	
	Bashkia Kurbin	Skuraj	1	
	Bashkia Mirditë	Katund i Vjetër	1	
		Orosh	1	
SHKODËR	Bashkia Shkodër	Drisht	1	
		Zogaj	1	
		Theth	1	
	Bashkia Vau Dejës	Mjedë	1	
		Kukël	1	
	Bashkia Pukë	Qelëz	1	
	Bashkia Fushë Arrëz	Kryezi	1	
	Bashkia Malësi e Madhe	Razëm/Vrith	1	
		Lëpushë	1	
	TIRANË	Bashkia Tiranë	Shëngjergj	1
Shesh			1	
Pezë			1	
Pëllumbas			1	
Bashkia Kamëz		Laknas	1	
Bashkia Vorë		Prezë	1	
		Marikaj	1	
Bashkia Kavajë		Karpen	1	
Bashkia Rrogozhinë		Vilë Bashtovë	1	
		German	1	
		Kaninë	1	
VLORË		Bashkia Vlorë	Tragjas	1
			Zvërnec	1
	Bashkia Himarë		Dhërm/Vuno	1
		Kuç	1	
		Lukovë	1	
		Bashkia Finiq	Mesopotam	1
	Bashkia Selenicë	Ploçë(Amantia)	1	
		Drashovicë	1	
	Bashkia Sarandë	Çukë	1	
	Bashkia Konispol	Mursi	1	
	Bashkia Delvinë	Rusan	1	
				100

**VENDIM****Nr. 22, datë 12.1.2018****PËR MIRATIMIN E KRITEREVE PËR
CERTIFIKIMIN E VEPRIMTARISË SË
AGROTURIZMIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 4, të ligjit nr. 93/2015, “Për turizmin”, me propozimin e ministrit të Turizmit dhe Mjedisit dhe ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:**I. PARIME TË PËRGJITHSHME**

1. Agroturizëm është veprimtaria pritëse, që zhvillohet në një fermë ose njësi tjetër agrikulturore, me qëllimin për të tërhequr vizitorë, shpeshherë duke u mundësuar atyre pjesëmarrjen në veprimtaritë bujqësore ose veprimtari të tjera ndihmëse, që zhvillohen në atë mjedis bujqësor.

2. Agroturizmi mbështet zhvillimin e turizmit të qëndrueshëm të zonave rurale nëpërmjet mbrojtjes së mjedisit, ruajtjes së traditave dhe promovimit të produkteve tipike të zonës.

3. Çdo subjekt që kërkon të ofrojë veprimtari pritëse të certifikuar, si “agroturizëm”, duhet të plotësojë kriteret e përcaktuara në këtë vendim. Vetëm subjektet e certifikuara sipas këtij vendimi kanë të drejtë të përdorin në emrin e tyre tregtar ose në ambientet e tyre emërtimin “agroturizëm”.

**II. KRITERET PËR CERTIFIKIMIN E
VEPRIMTARISË PRITËSE SI
“AGROTURIZËM”**

4. Agroturizmi, si veprimtari, mund të zhvillohet në ferma që plotësojnë këto kriteret:

- Ferma bujqësore duhet të ketë, të paktën, 1 ha tokë të mbjellë me kultura bujqësore ose, minimalisht, 0,5 hektarë serra;

- Ferma blegtorale duhet të mbarështojë, minimalisht, 10 krerë gjedh ose 100 krerë dele/dhi apo 200 krerë shpendë. Te fermat blegtorale klasifikohen edhe stanet;

- Ferma peshkimi/akuakulture.

5. Agroturizmi mund të zhvillohet edhe në njësi agrikulturore, që kanë si aktivitet përpunimin e produkteve bujqësore, blegtorale, të peshkimit e akuakulturës (si, p.sh., pika përpunimi të vajit të ullirit, kantina të përpunimit të rrushit/frutave, pika përpunimi të bulmetit/baxho, peshkut, ferma akuakulture etj.), të cilat janë të përshtatshme për

zhvillimin e veprimtarive të agroturizmit.

6. Subjektet, që zhvillojnë veprimtari pritëse të klasifikuar si “agroturizëm”, duhet të ofrojnë, minimalisht, njërin nga shërbimet e mëposhtme:

- a) Akomodim;

- b) Ushqim dhe pije;

- c) Veprimtari argëtuese/çlodhëse, të lidhura me fermën ose mjedisin përreth.

7. Subjektet agroturistike, që ofrojnë akomodim, duhet të kenë një kapacitet nga 6 deri 30, por jo më shumë, dhoma pritëse.

8. Strukturat, në të cilat ofrohet shërbimi i akomodimit, sipas klasifikimit të ligjit për turizmin në fuqi, duhet të respektojnë kriteret urbanistike dhe kriteret e tjera në fuqi për ndërtimin, të përcaktuara në planet e përgjithshme vendore. Atje ku është e mundur, godinat duhet të respektojnë traditat lokale të ndërtimit.

9. Akomodimi mund të ofrohet edhe në formën e fushimit, me ambiente për vendosjen e çadrave apo të makinave të fushimit. Në këto raste, subjekti agroturistik garanton kushtet minimale higjieno-sanitare (si, p.sh., tualet, ujë të pijshëm, pikë grumbullimi të mbeturinave, lidhje me energjinë elektrike) për një kapacitet maksimal prej 15 makinash fushimi.

10. Ofrimi i ushqimit dhe i pijeve bëhet në ambiente të përshtatshme dhe që plotësojnë normat në fuqi për ushqimin dhe kushtet higjieno-sanitare. Struktura pritëse, ku ofrohet ushqim dhe pije, duhet të ketë, minimalisht, 6 deri në 60, por jo më shumë, tavolina.

11. Ushqimi dhe pijet e ofruara në subjektet agroturistike duhet të jenë me origjinë nga ferma (të prodhuara ose të përpunuara në fermë/njësinë agrikulturore), minimalisht në 30% të sasisë së tyre. Nga 30% deri në 70% të produkteve ushqimore/pijeve lejohet të jenë me origjinë lokale, të prodhuara apo të përpunuara nga prodhues lokalë, që kryejnë aktivitetet në bashkinë ku ka selinë agroturizmi.

12. Subjektet agroturistike ofrojnë/mundësojnë për vizitorët e turistët veprimtari argëtuese/çlodhëse, që lidhen me fermën (si, p.sh., por pa u kufizuar në mbjellje/vjelje të produkteve bujqësore, aktivitete të lidhura me kafshët, peshkim artizanal, degustim të produkteve etj.) ose jashtë fermës (si, p.sh., por pa u kufizuar në hipizëm, alpinizëm, ecje në natyrë etj.)



III. ORGANET CERTIFIKUESE

13. Për certifikimin e subjekteve dhe dhënien e certifikatës “Subjekt i certifikuar agroturizmi”, pranë ministrisë përgjegjëse për turizmin ngrihet një komision vlerësues, i përbërë nga 5 anëtarë, 3 prej të cilëve janë përfaqësues të caktuar nga ministri përgjegjës për turizmin dhe 2 nga ministri përgjegjës për bujqësinë dhe zhvillimin rural.

14. Brenda 3 (tre) muajve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, ministri përgjegjës për turizmin dhe ministri përgjegjës për bujqësinë dhe zhvillimin rural përcaktojnë, me urdhër të përbashkët, rregulloren e funksionimit të komisionit, si dhe procedurat e aplikimit e të vlerësimit.

15. Subjektet, që aplikojnë për marrjen e certifikatës “Subjekt i certifikuar agroturizmi”, paguajnë një tarifë prej 500 (pesëqind) lekësh në llogarinë e ministrisë përgjegjëse për turizmin.

16. Bazuar në vendimmarrjen e komisionit, ministri përgjegjës për turizmin lëshon certifikatën “Subjekt i certifikuar agroturizmi”. Certifikata lëshohet për një periudhë 5-vjeçare.

17. Modeli i certifikatës miratohet me urdhër të përbashkët të ministrit përgjegjës për turizmin dhe ministrit përgjegjës për bujqësinë dhe zhvillimin rural.

18. Në rast konstatimi të shkeljes së kritereve të këtij vendimi nga organet përkatëse të bashkive, inspektoratit të turizmit ose organeve kompetente të inspektimit të ushqimit dhe kushteve higjieno-sanitare, komisioni, bazuar në kërkesën e organeve konstatuese të shkeljes, mund të marrë vendim për pezullimin dhe/ose revokimin e certifikatës “Subjekt i certifikuar agroturizmi”.

19. Subjektit të cilit i pezullohet/revokohet certifikata, nuk mund ta përdorë atë në ambientet e tij ose në emërtimin tregtar. Subjekti mund të aplikojë sërish për marrjen e certifikatës në rast se plotëson kriteret e përcaktuara nga ky vendim.

IV. DISPOZITA PËRFUNDIMTARE

20. Ministria përgjegjëse për turizmin mban regjistrin e subjekteve të certifikuara si “Subjekt i certifikuar agroturizmi” dhe e përditëson atë në mënyrë periodike.

21. Subjektet që, aktualisht, përdorin në emërtimin tregtar dhe ambientet e tyre emërtimin “agroturizëm”, detyrohen që brenda 6 (gjashtë) muajve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, të aplikojnë për marrjen e certifikatës “Subjekt i certifikuar agroturizmi”.

22. Ngarkohen Ministria e Turizmit dhe Mjedisit dhe Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

URDHËR Nr. 1, datë 5.1.2018

PËR DELEGIM KOMPETENCASH

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 28, 29, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar; të ligjit nr. 10 296, datë 8.7.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” dhe të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave të titullarit të Autoritetit Kontraktor për Procedurat e Prokurimit në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Sekretarit të Përgjithshëm, znj. Aurora Alimadhi.

2. Delegimi i kompetencave mbaron me revokimin e aktit të delegimit.

3. Ngarkohet për zbatimin e këtij urdhri Sekretari i Përgjithshëm.

4. Ky urdhër hyn në fuqi në datën 5.1.2018 dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I BUJQËSISË
DHE ZHVILLIMIT RURAL
Niko Peleshi

**URDHËR****Nr. 128, datë 5.1.2018****PËR DELEGIMIN DHE DISA RREGULLA
TË PËRFAQËSIMIT LIGJOR TË
MINISTRISË SË DREJTËSISË**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës, të nenit 128, të ligjit nr. 44, datë 30.4.2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”,

URDHËROJ:

1. Autorizimet për përfaqësimin ligjor të Ministrisë së Drejtësisë në proceset gjyqësore, kur thirret si palë në një gjykim, lëshohen nga Sekretari i Përgjithshëm, në emër të personit/personave që do të përfaqësojnë ministrinë.

2. Autorizimet për përfaqësimin ligjor të Ministrisë së Drejtësisë, kur thirret si palë në gjykim, në proceset gjyqësore në të cilat objekti i padisë ka lidhje me institucionin e varësisë, lëshohen në emër të personit/personave që do të përfaqësojnë ministrinë nga drejtuesi i institucionit të varësisë, sipas vendit ku është ngritur kërkesëpadia.

3. Modeli i autorizimit për përfaqësimin në proceset gjyqësore të jetë sipas lidhjes nr. 1 bashkëlidhur këtij urdhri.

4. Përfaqësimi për çdo proces gjyqësor bëhet nga juristë të Sektorit të Përfaqësimit Gjyqësor, pranë Drejtorisë së Miradministrimit të Burimeve Njerëzore, Aseteve dhe Shërbimeve, specialistë të fushës për të cilën është ngritur kërkesëpadia, si dhe përfaqësues nga institucionet e varësisë së Ministrisë së Drejtësisë, nëpërmjet autorizimit përkatës.

5. Përfaqësimi ligjor i Ministrisë së Drejtësisë në proceset gjyqësore, sipas këtij urdhri, i jep të drejtë përfaqësuesve të autorizuar të kryejnë çdo veprim procedural, të parashikuar nga legjislacioni në fuqi, në kuadër të përfaqësimit në shkallën përkatëse të gjykimit.

6. Përfaqësuesit e caktuar të ndjekin me korrektësi seancat gjyqësore, për sa i takon pjesëmarrjes së tyre e, veçanërisht, kontributit provues, paraqitjes së kërkesave, prapësimeve, pretendimeve, ankimeve, rekurseve, si dhe dokumenteve të tjera, që do të ndihmonin mbrojtjen e interesave të institucionit të Ministrisë së Drejtësisë.

7. Në përfundim të proceseve gjyqësore, në çdo shkallë të gjyqësorit, brenda një afati 5-ditor nga shpallja-njoftimi i vendimit, të paraqitet informacion i detajuar, i shoqëruar (aty ku është e mundur) me vendimet përkatëse në Ministrinë e Drejtësisë.

8. Ngarkohen të gjitha institucionet e varësisë së Ministrisë së Drejtësisë, të caktojnë një person përgjegjës, që do të jetë pikë kontakti për të shkëmbyer çdo informacion të nevojshëm, si dhe njoftim për ecurinë e ndjekjen e proceseve gjyqësore, me Sektorin e Përfaqësimit Gjyqësor, pranë Drejtorisë së Miradministrimit të Burimeve Njerëzore, Aseteve dhe Shërbimeve, në Ministrinë e Drejtësisë.

9. Ngarkohet Sektori i Redaktimit Gjuhësor, Shërbimeve dhe Arkiv-Protokollit për vënien në dispozicion të dokumenteve të nevojshme, me qëllim paraqitjen e tyre konform ligjit, në cilësinë e provave materiale për proceset gjyqësore.

10. Ngarkohen Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Miradministrimit të Burimeve Njerëzore, Aseteve dhe Shërbimeve, Sektori i Përfaqësimit Gjyqësor, Sektori i Arkiv-Protokollit, institucionet e varësisë së Ministrisë së Drejtësisë, për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**MINISTRI I DREJTËSISË
Etilda Gjonaj (Saliu)**

**(SEKRETARI I PËRGJITHSHËM /
INSTITUCIONI I VARËSISË)**

Nr. ... prot.

Tiranë, më . .2018

**AUTORIZIM PËR PËRFAQËSIMIN NË
ÇËSHTJEN GJYQËSORE ME PALË:**

Paditës: ...

E paditur: ...

Objekti: ...

Në mbështetje të neneve 64–77 të Kodit Civil, të nenit 96 të Kodit të Procedurës Civile, të nenit 14, të ligjit nr. 49, datë 3.5.2012, “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, dhe të urdhrit të ministrit të Drejtësisë nr. ... , datë ..., “Për delegimin dhe disa rregulla të përfaqësimit ligjor të Ministrisë së Drejtësisë”,



VENDOSA:

Autorizimin e ... dhe ... për të përfaqësuar Ministrinë e Drejtësisë, së bashku ose veç e veç, në bashkëpunim me Avokaturën e Shtetit, në të gjitha seancat gjyqësore të procesit ..., me nr. ... akti, pranë Gjykatës ...

Përfaqësuesi ka të drejtë të përgatisë, të nënshkruajë e të depozitojë të gjitha aktet e nevojshme procedurale para gjykatës, në përputhje me ligjin dhe në interesin e ligjshëm të palës së paditur, Ministrinë e Drejtësisë, të cilën përfaqëson, deri në marrjen e formës së prerë të vendimit.

(SEKRETARI I PËRGJITHSHËM/DREJTUESI
I INSTITUCIONIT TË VARËSISË)

NJOFTIM

Nr. 275, datë 9.1.2018

**MBI HYRJEN NË FUQI TË NJË
MARRËVESHJEJE NDËRKOMBËTARE**

Marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Tunizisë, “Për heqjen e vizave për mbajtësit e pasaportave diplomatike”, nënshkruar në Nju-Jork, më 19.9.2017, ka hyrë në fuqi më 4.12.2017.

SEKRETARI I PËRGJITHSHËM
I MINISTRISË PËR EVROPËN
DHE PUNËT E JASHTME
Gazmend Barbullushi

NJOFTIM

Nr. 418, datë 11.1.2018

**MBI HYRJEN NË FUQI TË DISA
MARRËVESHJEJE NDËRKOMBËTARE**

1. Marrëveshje ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe komandës supreme të fuqive Aleate në Evropë (SHAPE), “Për patrullimin e hapësirës ajrore të Republikës së Shqipërisë”, nënshkruar më 22.2.2016, hyrë në fuqi më 9.2.2017.

2. Marrëveshje ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Shtabit Suprem të Fuqive Aleate në Evropë dhe Shtabit të Komandës Supreme Aleate për Transformimin në plotësim të Protokollit të Parisit, nënshkruar më 26.5.2014, hyrë në fuqi më 21.2.2017.

SEKRETARI I PËRGJITHSHËM
I MINISTRISË PËR EVROPËN
DHE PUNËT E JASHTME
Gazmend Barbullushi

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2018

Adresa: Rr. “Nikolla Jorga”, Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 196 lekë